

رسالة في القضاء والقدر
KADAJA DHE KADERI
Përcaktimet e Zotit

○ Muhamed ibën Salih elUthejmin ○

رسالة في القضاء والقدر

Kadaja dhe Kaderi Përcaktimet e Zotit

Autori:

Muhamed ibën Salih elUthejmin

Përktheu:

Besim Gjellaj

Redaktor gjuhesorë:

Sylë Dinaj

Titulli në arabisht: رسالة في القضاء والقدر

Titulli në shqip: Kadaja dhe Kaderi Përcaktimet e Zotit

Autor: Muhamed ibën Salih elUthejmin

Përkthyes: Besim Gjelaç

Redaktor gjuhësor: Sylë Dinaj

Website: www.indeksiislam.com

All rights reserved

ان الحمد لله، نحمده ونستعينه ونستغفره، ونعوذ بالله
من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا، مَنْ يَهْدِهِ اللهُ
فلا مضلَّ له، ومن يضلل فلا هادي له، وأشهد أن
لا إله إلا الله وحده لا شريك له، وأشهد أن محمدًا
عبده ورسوله،

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ
إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ﴾ [آل عمران: 102]

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ
وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا
وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ
كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا﴾ [النساء: 1]

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا
يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ
وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا﴾ [الأحزاب: 70 - 71]

أما بعد
فإنَّ أصدق الحديث كلام الله تعالى، وخير الهدي
هدي محمدٍ صلى الله عليه وسلم وشر الأمور
محدثاتها، وكلُّ محدثة بدعة، وكلُّ بدعة ضلالة،
وكلُّ ضلالة في النار

Hyrje

Falënderimet i takojnë All-llahut, Atë e falenderojmë, dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë dhe tek Ai pendohemi.

Kërkoj mbrojtjen e All-llahut nga të këqijat e vetës sonë dhe nga të këqijat e veprave tona, atë që All-llahu e udhëzon s'ka kush që e humb, e atë që e humb s'ka kush që e udhëzon.

Dëshmoj që nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë pos All-llahut, i Cili është Një dhe i pashoq, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, të cilin e ka dërguar All-llahu para ardhjes së kjametit, përgëzues dhe çortues, thirrës në rrugën e All-llahut me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues për të humburit, e komunikoi shpalljen, e përmbushi amanetin, e këshilloi umetin, dhe bëri xhihad të vërtetë në rrugën e All-llahut gjersa i erdhi vdekja, paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të dërguarin tonë, mbi sahabët dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në ditën e kjametit.

Vëllezër të nderuar! Ne jemi në këtë takim ku shpresoj se All-llahu do t'i hap për ne dyert e dhuntive dhe mëshirës, të na bëjë prej të udhëzuarve dhe thirrësve në rrugën e Tij, prej prijësave përmirësues, prej atyre që kur dëgjojnë fjalët e All-llahut përfitojnë prej tyre.

Ne në këtë takim do të flasim për një çështje me rëndësi që i intereson çdo besimtari, e ajo është: "**Kadaja dhe Kaderi**".

Kjo temë elhamdulillah është e qartë, mirëpo sikur dyshimet rreth saj të mos ishin të shumta dhe sikur kjo temë të mos ishte e ngatërruar te disa njerëz, e të mos ishte numri i madh i atyre që iu qasen kësaj teme -herë me të drejtë e shumëherë pa të drejtë-, gjithashtu duke pasur në konsideratë se bidatet dhe epshet janë përhapur dhe shumë, e që shumë mëkatarë mundohen t'i arsyetojnë mëkatet e tyre me kada dhe kader, sikur të mos ishin këto dhe gjëra të tjera, nuk do të bisedonim fare rreth saj.

Rreth kadasë dhe kaderit vazhdimisht ka pasur kundërthënie në mesin e muslimanëve, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, transmetohet se Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i ka parë sahabet duke polemizuar rreth kaderit, i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem posa e pa këtë i ndaloi nga kjo dhe ju tregoi atyre se popujt e mëhershëm u shkatërruan si shkak i polemikave rreth kaderit.¹

Por, All-llahu i Lartësuar ua ka bërë të qartë besimtarvë të vet, gjeneratave të para të muslimanëve (selefus-salih), të cilët e trasuan rrugën e drejtë në atë çka mësuuan dhe në atë që e thonin, se përcaktimet e All-llahut të Lartësuar janë prej rububijetit* të Tij i cili është një prej tri llojeve të tevhidit, ashtu siç e kanë ndarë dijetarët:

Iloji i parë: "*Teuhidul-uluhije*" që do të thotë: "Njëshmëria e All-llahut në adhurim";

Iloji i dytë: "*Teuhidurr-rububije*" që do të thotë: "Njëshmëria e All-llahut në krijim, sundim, sistematizim";

Iloji i tretë: "*Teuhidul-esma ves-sifat*" që do të thotë: "Njëshmëria e All-llahut me emrat dhe cilësit e Tij".

¹ Tra.Tirmidhiu (2133), Ibni Maxhe (85).

* Rububijeh-është të besuarit se vetëm All-llahu është krijues, furnizues, sundues, rregullues i gjithësisë

Pra, besimi në kader është prej rububijetit të All-llahut të Plotëfuqishëm, ku për këtë Imam Ahmedi -All-llahu e mëshiroftë- thotë: ***"Kaderi është fuqia e Allahut"***, sepse kaderi është prej fuqisë së Tij dhe nuk ka dyshim në të, gjithashtu ai është një prej sekreteve të Allahut subhanehu ve te'ala, të cilin nuk e di askush përveç Tij, i shkruar në Lehvi-Mahfudh¹, në një libër të ruajtur te i cili nuk depërton askush, dhe ne nuk e dimë se çka ka caktuar All-llahu për neve -keq apo mirë-, apo atë që ka caktuar për krijesat e Veta përderisa të ndodhë, apo të kuptohet ai caktim prej paralajmërimeve të vërteta që kanë ardhur nga All-llahu i Plotëfuqishëm.

Vllëzër të nderuar! Muslimanët, në lidhje me çështje të kaderit, janë ndarë në tri grupe;

grupi i parë: e tepruan në pohimin e kaderit, ia mohuan njeriut fuqinë dhe vullnetin e tij, duke thënë: "Njeriu nuk ka fuqi, nuk ka zgjedhje por është i detyruar, e shembulli i tij është si pema që lëkundet nga era", dhe nuk kanë bërë dallim në mes veprimit të njeriut i cili ndodhë më vullnetin e tij dhe veprimit që ndodhë pa vullnetin e tij.

Pa dyshim të tillët janë të devijuar, sepse, siç dihet nga feja, mendja e shëndoshë dhe përvoja, njeriu di të bëjë dallimin në mes veprimit të lirë dhe veprimit të detyruar.

grupi i dytë: e tepruan duke pohuar fuqinë dhe vullnetin e njeriut, sa që i mohuan All-llahut të Lartësuar dëshirën, vullnetin dhe krijimin e asaj që e bëjnë robërit e Tij, duke menduar se njeriu është i lirë tërsisht në veprën e tij, ndërsa disa të tjerë shkuan edhe më largë se kjo duke thënë: "All-llahu i Lartësuar nuk e di atë që e bëjnë krijesat, përderisa veprimi nuk ndodhë", poashtu edhe këta sikur grupi i parë e tepruan dhe shkuan në ekstrem duke e pohuar vullnetin e lirë të njeriut.

grupi i tretë: janë ata të cilët besuan drejtë dhe i udhëzoi All-llahu në rrugën e vërtetë, e këta janë Ehlu-suneh uel-xhema'ah, të cilët i janë përmbajtur rrugës së mesme, e ngritur në argumente sheriatike dhe atë logjike, dhe thanë: "Veprimet të cilat ndodhin në këtë botë janë më dëshirën e All-llahut subhanehu ue te'ala dhe ndahen në dy grupe":

¹ Liber në të cilin është e shkruar çdo gjë deri në ditën e kجامetit.

- veprime që ndodhin të krijesat e All-llahut subhanehu ue te'ala me dëshirën e Tij dhe në këto veprime nuk ka zgjedhje për askënd, si p.sh. zbritja e shiut, dalja e bimëve, jeta, vdekja, sëmundja, shëndeti dhe shumë gjëra tjera që janë prezente te krijesat e All-llahut të Lartësuar, këtu pa dyshim se nuk ka mundësi askush të zgjedhë dhe në to nuk ka dëshirë askush, por vullneti dhe dëshira në këto veprime i takon vetëm All-llahut të Plotëfuqishëm;
- veprimet e krijesave që kanë mundësi zgjedhjeje, të gjitha këto veprime janë nga vullneti dhe dëshira e krijesave, ngase All-llahu i ka lënë ata të lirë në këto veprime, thotë Allahut i Lartësuar:

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ

***"(Kur'ani është përkujtues) Për këdo prej jush i cili dëshiron të ndjekë rrugën e vërtetë"*², gjithashtu i Lartësuari thotë:**

مَا تُحِبُّونَ مِنْكُمْ مَنْ يُرِيدُ الدُّنْيَا وَمِنْكُمْ مَنْ يُرِيدُ الْآخِرَةَ

***"Nga mesi juaj ka të atillë që e dëshirojnë këtë botë dhe të atillë që dëshirojnë botën tjetër"*³, thotë All-llahu:**

فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ

***"E kush të dojë, le të bësojë, e kush të dojë, le të mohojë"*⁴**

edhe njeriu e di se çka ndodhë me vullnetin e tij dhe çka ndodhë përkundër vullnetit të tij, nëse njeriu zbret nga kulmi me shkallë me dëshirën e tij e di se po e bë me dëshirë të vet, mirëpo mund të ndodhë të bie nga kulmi dhe e di se nuk po e bë me dëshirën e tij, pra e dinë dallimin në mes dy veprimeve, veprimi i dytë është përkundër dëshirës së tij, kurse i pari është me dëshirën e tij, domethënë këtë gjë e di çdo njeri.

² (Et-Tekvir 28)

³ (Ali Imran 152)

⁴ (El-Kehf29)

Po ashtu, nëse ndokush është i sëmurë nga prostata, është i vetëdijshëm se dalja e urinës ndodhë pa dëshirën e tij, po sikur të ishte i shëndosh nga kjo sëmundje, pa dyshim se kryerja e këtij veprimit do të bëhëj më dëshirën e tij, pra, ka dallim në mes këtyre dy veprimeve dhe askush nuk ka mundësi ta mohojë këtë. Kështu që çdo gjë që ndodhë nga ana e njeriut ka mundësi të dihet se a është më vullnetin e tij apo është i detyruar.

Mirëpo, prej mëshirës së All-llahut të Plotëfuqishëm është që disa veprime parimisht ndodhin me vullnetin e njeriut dhe të mos jep fare llogari për to, sikur janë vepërat e atij që harron apo atij që fle, thotë All-llahu i Lartësuar në tregimin që flet rreth banorve të shpellës "As'habul-kehf":

وَنُقَلِّبُھُمْ ذَاتَ الْيَمِينِ وَذَاتَ الشِّمَالِ

"E Ne i rrotullonim ata herë në krahun e djathtë e herë në të majtin"⁵

do të thotë ata rrotulloheshin, mirëpo All-llahu i Lartësuar këtë vepër ia referoi vetëvetës së Tij, sepse ai i cili fle nuk ka vullnet dhe nuk llogritet për veprën e tij, për këtë All-llahu i Lartësuar e përshkroi veprën si të vetën.

Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: "**Kush harron, ha apo pi duke qenë agjerueshëm, le ta plotësojë agjerimin e tij, sepse atë All-llahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë për të pirë**", Pejgamberi ia atriboi këtë vepër All-llahut, ngase ky veprim kishte ndodhur nga njeriu duke mos e kujtuar se është agjërueshëm, dhe u konsiderua si të ishte përkundër vullnetit të tij.

Çdonjëri e ka të njohur dallimin në mes dhimbjes që e ndien pa dëshirën e tij dhe atë lehtësimin që e ndien në vetvetën e tij njëashtu pa vullnetin e tij, duke mos e ditur ç'është shkaku i kësaj dhimbjeje apo atij lehtësimi, dhe mes dhimbjes që është si rezultat i veprës së tij, apo gëzimit që është bërë shkaktar për të dhe kjo çështje është e kuptueshme uel-hamdulilah dhe nuk ka paqartësi në të.

O ju vllëzer! Nëse ne e përkrahim mendimin e grupit të parë, të cilët e tepruan duke pohuar kaderin, do të shkatërrohej sheriatu që nga themeli, sepse mendimi se njeriu nuk është i lirë në veprim do të thotë të mos

⁵ (El-kehf 18)

lavdërohet kur vepron ndonjë vepër të ndershme dhe të mos qortohet kur kryen ndonjë vepër të shëmtuar, ngase ai faktikisht këto vepra i ka bërë pa dëshirën dhe vullnetin e tij, e mbështetur në këtë, rezultati del se All-llahu -*qoftë i Lartësuar dhe i Patëmeta*- është i padrejtë ndaj atij që bën mëkat kur e ndëshkon atë për mëkatin që e ka bërë, sepse ai e ka denuar atë për një vepër që ai nuk ka zgjedhje dhe vullnet të lirë në të, e kjo padyshim bie qartë ndesh me Kur'anin, ku thotë All-llahu i Lartësuar:

وَقَالَ قَرِينُهُ هَذَا مَا لَدَيَّ عَتِيدٌ أَلْقِيَا فِي جَهَنَّمَ كُلَّ كَفَّارٍ عَنِيدٍ مَّنَّاعٍ لِّلْخَيْرِ مُعْتَذِرٍ مُّزِيبٍ أَلَّذِي جَعَلَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا ءَاخَرَ فَأَلْقِيَاهُ فِي الْعَذَابِ الشَّدِيدِ قَالَ قَرِينُهُ رَبَّنَا مَا أَطْغَيْتُهُ وَلَكِنْ كَانَ فِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ قَالَ لَا تَخْتَصِمُوا لَدَيَّ وَقَدْ قَدَّمْتُ إِلَيْكُمْ بِالْوَعِيدِ مَا يُبَدِّلُ الْقَوْلُ لَدَيَّ وَمَا أَنَا بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ

"E (meleku) shoqërues i tij do të thotë: "Ja ku e kam me vete gati (regjistrin e veprave). (All-llahu iu thotë) Ju të dy (engjëjt) hidhnie në xhehenem secilin mohues kryeneç. Secilin pengues të veprave të mira, mizor e të dyshimtë në fe. I cili All-llahut i shoqëroi zot tjetër, pra hidhnie atë në vuajtjet më të rënda. E shoku i tij (djalli thotë): "Zoti ynë, unë nuk e shmanga prej rrugës së drejtë, por ai vetë ka qenë në humbje të madhe". Ai (All-llahu) thotë: "Mos u grindni tash para Meje, se Unë me parë ju tërhoqa vërejtjen. Tek Unë nuk ndryshon fjala (vendimi) dhe Unë nuk jam zullumqar për robërit"⁶.

All-llahu subhanehu ue te'ala na ka treguar në këto ajete se ky ndëshkim nuk është i padrejtë, përkundrazi është prej drejtësisë së Tij absolute, për arsye se All-llahu më parë ua kishte tërhjekur vërejtjen, ua kishte sqaruar atyre rrugën, ua kishte bërë të qartë të vërtetën nga e pavërteta, mirëpo njerëzit ishin ata që vendosën për vetën e tyre që të pasojnë rrugën e gabueshme, kështu që atyre nuk ju ka mbetur ndonjë arsye para All-llahut.

⁶ (El-Kaf 23-29)

Po ashtu sikur të thonim se ata do të kenë arsye (me kader) para All-llahut të Lartësuar, atëherë nuk do të kishte kurrfarë kuptimi fjala e All-llahut:

رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

"Të dërguarit ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve (pejgamberve) njerëzit të mos kenë arsye para All-llahut"⁷.

Më të vërtetë All-llahu i Lartësuar ua ka mohuar njerzëve të kenë arsye pas dërgimit të pejgambërve, sepse ata ua kanë shfaqur atyre argumentet (që thërrasin në pasimin e rrugës së All-llahut subhanehu ue te'ala), e nëse do të ishte kaderi argument për ta, atëherë patjetër ky argument do të mbetej edhe pas dërgimit të pejgamberëve, ngase kaderi i All-llahut është vazhdimisht prezentë, para ardhjes së pejgamberve dhe pas ardhjes së tyre, pra këtë mendim e zhvlersojnë citatet (qofshin ato nga Kur'ani apo nga Suneti), njëashtu këtë mendim e zhvleron edhe realiteti siç e cekëm më parë.

Ndërsa, sa i përket mendimit të dytë, po ashtu edhe këtë mendim e zhvlerësojnë citatet dhe realiteti, ngase citatet janë të qarta se dëshira e njeriut është nën dëshiren e All-llahut az-ze ue xhel, thotë All-llahu i Lartësuar:

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

"(Kur'ani është përkujtues) Për këdo prej jush i cili dëshiron të ndjekë rrugën e vërtetë. Po ju nuk mundeni (ta ndiqni rrugën e vërtetë), vetëm nëse dëshiron All-llahu, Zoti i botëve!"⁸.

Thotë i Lartësuari:

وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ

"Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë"⁹.

⁷ (En-Nisa 165)

⁸ (Et-Tekvir 28-29)

⁹ (El-Kasas 68)

Thotë All-Ilahu i Lartësuar:

وَاللَّهُ يَدْعُوا إِلَى دَارِ السَّلَامِ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

"All-Ilahu thërret për në xhennet, dhe atë që do, e vë në rrugë të drejtë"¹⁰.

Ata të cilët pohojnë këtë mendim, në realitet kanë mohuar një aspekt prej aspekteve të tevhidurr-rrububije, ata gjithashtu pretendojnë se në mbretërinë e All-Ilahut të Lartësuar ka diç të cilën All-Ilahu nuk e dëshiron dhe të cilën nuk e ka krijuar fare, por, dihet fare mirë se çdo gjë që gjindet është me dëshirën e All-Ilahu, Ai është krijues i asaj gjëje, dhe Ai e ka caktuar të jetë ashtu.

Këta krahas këtijë mendimi kundërshtojnë një parim i cili dihet medeomos, se tërë krijesat, qeniet (trupat) e këtyre krijesave dhe cilësitë e tyre janë pronë e All-Ilahut të Plotëfuqishëm, dhe se nuk ka dallim në mes qenieve dhe attributeve të tyre, pra të gjitha janë pronë e All-Ilahut az-ze ue xhel dhe nuk ka mundësi të ndodh diç në pronësinë e Tij pa pasur Ai dëshirë të ndodhë ajo gjë.

Por, neve na mbetet të pyesim, nëse kjo çështje është e ndërlidhur me dëshirën e All-Ilahut të Lartësuar, dhe se çdo gjë është në dorën e Tij, atëherë cila është zgjidhja e njeriut apo largimi i tij nga kaderi i All-Ilahut, nëse All-Ilahu atijë i ka caktuar që të devijojë e të mos udhëzohet?

Përgjigjeja për këtë është: All-Ilahu i Lartësuar e udhëzon atë që meriton për t'u udhëzuar dhe e le të humbur atë që meriton të jetë i humbur, thotë All-Ilahu i Lartësuar:

فَلَمَّا زَاغُوا أَزَاغَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ

"E kur ata u shmangën (nga e vërteta), All-Ilahu ua devijoi zemrat e tyre"¹¹.

¹⁰ (Junus 25)

¹¹ (Es-Saff 5)

فَبِمَا نَفَضِهِمْ مِّثْقَاهُمْ لَعَنَّاهُمْ وَجَعَلْنَا قُلُوبَهُمْ قَاسِيَةً يُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ عَنْ مَوَاضِعِهِ^{١٢} وَنَسُوا حَظًّا مِمَّا ذُكِّرُوا بِهِ

"Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata, dhe zemrat e tyre i bëmë të forta (të shtangura). Ata i ndryshojnë fjalët (në Tevrat) nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar"¹².

All-llahu i Lartësuar ka sqaruar se shkakun pse All-llahu i bëri ata të devijojnë është vetvetja e tyre, sepse siç e cekëm më parë njeriu nuk e di se çka i është përcaktuar atij, ngase ai nuk e dinë kaderin përveç pasi që të ndodhë dhe ai nuk e di se a i ka caktuar All-llahu atij të jetë prej të humburëve apo të jetë prej të udhëzuarve?

E ç'është puna e tij së pari e ndjek rrugën e humbjes pastaj arsyetohet se All-llahu ka dashur një gjë të tillë, a nuk do ishte e udhës për të që të zgjidhte rrugën e udhëzimit e pastaj të thotë; Me të vërtetë All-llahu më ka udhëzuar në rrugë të drejtë?

A është e drejtë të thuhet nëse kam devijuar jam i detyruar, nëse jam udhëzuar unë jam i lirë të zgjedhë?

Kurrësesi, nuk i përket njeriut të jetë i detyruar në devijim e mëkate, nëse devijon apo bën mëkat ndaj All-llahut të thotë se kjo është një çështje e shkruar dhe përcaktuar për mua dhe se unë nuk mund të dal jashtë paracaktimit të All-llahut.

Në anën e kundërt për përlulje ndaj All-llahut, nëse Ai e ka udhëzuar në përlulje dhe rrugë të drejtë, të pretendojë se kjo është si rezultat i punës së vet dhe të lavdërohet para All-llahu me këtë vepër e të thotë; "unë jam ai i cili vetë jam udhëzuar", e kjo do të thotë se ai është i lirë në përlulje ndërsa i detyruar në mëkate, e kjo nuk qëndron ashtu, ngase njeriu në realitet ka forcë dhe mund të zgjedhë, dhe nuk është puna e udhëzimit më ndryshe se puna e rrizkut apo puna e kërkimit të diturisë.

¹² (El-Maide 13)

Njeriu siç e dimë të gjithë, i është caktuar rrizku mirëpo ai përkundrazi vrapon pas shkaqeve që e sjellin atë, qoftë në vend të vetë apo jashtë vendit të tij, djathtas apo majtas dhe asesi nuk ulet në shtëpi e të thotë; "se nëse më është caktuar mua diç prej rrizkut patjetër do të më vije", por përkundrazi ai nxiton në kërkimin e tij edhe pse dihet se rrizku është i shoqëruar me punë ashtu siç është cekur nga Pejgamberi alejhis-selam në hadithin që e transmeton Ibën Mesudi radijall-llahu anhu ku thotë: **"Vërtet, çdo njeri nga ju formohet në barkun e nënës së tij katërdhjetë ditë si nutfëh (lëngë i ngjizur i bashkëdyzimit të vezës mashkullore dhe asaj femërore), pastaj ai lëng bëhet alekah (copë gjaku i ngjizur e i varur) ngjashëm më këtë periodë, pastaj ai gjak bëhet mudgah (copë mishi) ngjashëm më këtë periodë, pastaj i dërgohet një engjull i cili e frymëzon në të shpirtin, dhe ai engjull urdhërohet me katër gjëra; ta shkruan rrizkun, exhelin (sa do të jetojë), veprat dhe a do të jetë i lumtur apo palumtur (a do të jetë prej banorëve të xhenetit apo të xhehenemit)..."⁵.**

Domethënë, edhe rrizku është i shkruar ashtu siç janë edhe veprat e shkruara, qofshin ato të mira apo të këqija.

Atëherë pse ti ecën në të djathtë dhe në të majtë? E shetitë tërë tokën me qëllim që ta kërkosh rrizkun në këtë botë, e nuk bënë ndonjë vepër të mirë që përmes atyre veprave të mira ta kërkosh rrizkun e ahiretit dhe të fitosh vendbanimin ku ka begati (xhenetin).

Me të vërtetë, të dy gjërat janë të ngjashme nuk ka dallim mes tyre, nxiton pas rrizkut tënd për të bërë një jetë të lumtur dhe më të gjatë, nëse të godet ndonjë sëmundje, dëshiron të shkosh po edhe në skaje të botës, më qëllim të kërkosh ndonjë mjek të shkathtë për ta shëruar sëmundjen.

Megjithatë, ti do të jetosh aq sa të është caktuar të jetosh dhe ajo (jeta) as nuk do të shtohet e as nuk do të shkurtohet dhe ti nuk mbështetesh në këtë e të thuash se do të qëndroj në shtëpi i sëmurë dhe i shtrirë e nëse ka caktuar All-llahu për mua të jetoj më gjatë do të jetoj.

Përkundrazi, ne të shohim duke nxituar më gjithë mundësitë që i posedon për t'a gjetur një mjek në të cilin shpreson se All-llahu do ta caktojë shërimin tënd përmes duarve e tij!

⁵ Tra.Buhariu (3208),,Muslimi (2643).

Pse nuk vepron për ahiret punë të mira ashtu si vepron për këtë botë?
E kemi cekur edhe më heret se kaderi i All-llahut është çështje e fshehët,
s'ke mundësi të dish për të, ashtu që ti gjendesh në mes dy rrugëve:

- 1.** rrugë e cila të dërgon në shpëtim, fitore, lumturi dhe krenari,
- 2.** rrugë e cila të dërgon në shkatërrim, pendim dhe nënçmim.

Ti, tani gjindesh mu në mes këtyre dy rrugëve, ke mundësi të zgjedhësh,
nuk ka kush që të ndalon që të pasosh rrugën e djathtë (të drejtë) apo të
pasosh rrugën e majtë (të devijimit), nëse do ecë në këtë dhe nëse do
ecë në atë.

Ç'është puna jote, zgjedhë rrugën e majtë e pastaj thua më është
caktuar ta zgjedhe këtë rrugë, a nuk bën të ecësh rrugës se djathtë e të
thuash kjo më është caktuar mua?!

Sikur ti dëshiron të udhëtosh për në ndonjë vend, dhe përpara teje
gjenden dy rrugë, njëra prej tyre është e shtruar, e shkurtër dhe e
sigurtë, kurse, tjetra nuk është e tillë, do të shihnim duke shkuar rrugës
se shtruar, të shkurtër dhe të sigurtë dhe jo rrugës e cila është e
pashtruar, e gjatë dhe jo e sigurtë?!

Kështu ndodhë në një rrugë lëndore, por edhe rruga shpirtërore është e
ngjashme me të dhe nuk ndryshon aspak nga ajo e para, por janë ato
ndjenjat dhe epshet të cilat nganjëherë e dirigjojnë mendjen dhe
ngadhnien ndaj saj, kurse besimtari është ai i cili mendja e tij
ngadhnjen ndaj epshit të tij dhe nëse mendja është ajo e cila ngadhnjen,
atëherë kuptohet se mendja e shëndoshë është ajo që e bën të
vetëdijshëm njeriun se çka i bën dëm atij dhe e drejton kah ajo që i bën
dobi dhe e bën të lumtur.

Nga kjo na bëhët e qartë se njeriu është i lirë në veprimet e tij në të cilat
është i lirë dhe nuk është i detyruar, ashtu siç është i lirë në veprimet që
kanë të bëjnë me këtë botë si p.sh; bën tregëti me cilin mall dëshiron ai,
njëashtu edhe në veprimet që kanë të bëjnë me ahiretin edhe në to ai
është i lirë, bile bile rrugët për në ahiret janë shumë më të qarta se sa
rrugët e dunjas, ngase ai i cili i sqaroi rrugët e ahiretit është All-llahu në
librën e Tij dhe përmes gjuhës së Dërguarit të Tij, dhe medeomos rrugët
e ahiret duhet të jenë më të qarta dhe më të çiltëra se sa rrugët e
dunjas.

E njeriu megjithatë ecë rrugëve të dunjas të cilat nuk janë garantuese në rezultatet e tyre, e i lenë rrugët e ahiretit, rezultatet e të cilave janë të garantuara dhe të njoftura, ngase janë të garantuara me premtinin e All-lahut, e All-llahu i Lartësuar nuk e then premtimin.

Pas tërë kësaj mund të themi; Me të vërtetë eh-lus-suneh uel-xhema'ah e kanë aprovuar këtë dhe e kanë bërë besim dhe drejtim të tyre, se njeriu është i lirë në veprimin e tij dhe se ai flet çka të dojë, mirëpo dëshira dhe vullneti i tij janë nën vullnetin dhe dëshirën e All-llahut tebareke ue te'ala.

Po ashtu Eh-lus-suneh uel-xhema'ah besojnë se dëshira e All-llahut është pasuese e urtësisë së Tij, që do të thotë se dëshira e All-llahut të Lartësuar nuk është pa ndonjë urtësi, përkundrazi është ajo e ndërlikur ngushtë me urtësinë e Tij subhanehu ue te'ala, sepse prej emrave të All-llahut të Lartësuar është edhe emri El-hakim (i Urtë), e Hakim do të thotë Gjykues i Cili i gjykon çështjet në aspektin universal dhe atë sheriatik dhe i Cili sistematizon ato në vepër dhe krijim, All-llahu i Lartësuar cakton udhëzimin për atë që do dhe për atë të cilin dihet se ai e dëshiron hakun (të vërtetën) dhe e di se zemra e tij është e përqëndruar në fenë e Tij, dhe cakton devijimin për atë që do dhe të cilit kur iu është afruar Islami iu kishte ngushtuar gjoksi sikur të ishte duke u ngritur në qiell (d.m.th nuk e kishte pranuar Islamin). Më të vërtetë, urtësia e All-llahut të Lartësuar kundërshton që ky të jetë prej të udhëzuarve, përveç nëse All-llahu ripërtrinë në zemrën e tij vendosshmëri (për të besuar) dhe dëshirën e tij e shëndreron në një dëshirë tjetër. All-llahu i Lartësuar është i Plotëfuqishëm përmbi çdo gjë, mirëpo prej urtësisë së All-llahut është që rezultatet janë të lidhura me shkaqet e tyre.

Kategoritë e Kadas dhe Kaderit tek Ehlus-suneh uel-xhema'ah janë katër:

Kategoria e parë; Dituria, kjo do të thotë se njeriu është i obliguar të besojë bindshëm se All-llahu i Lartësuar është i gjithëdijshëm, di për çdo gjë që ekziston në qiej dhe në tokë në mënyrë të përgjithshme dhe të përpiktë, pa marrë parasysh se a është kjo prej veprave të Tij apo prej veprave të krijesave të Tij dhe se Atij nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë dhe në qiell.

Kategoria e dytë; Shkrimi, do të thotë se All-llahu i Lartësuar i ka shkruar caktimet e çdo gjëje në Lehvil-Mahfudh. All-llahu subhanehu ue te'ala i ka përmëndur së bashku këto dy cilësi në fjalën (ajetin) e Tij:

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِنَّ ذَلِكَ فِي كِتَابٍ
إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ

***"A nuk e ke ditur se All-llahu di çka ekziston në qiell e në tokë, e tërë ajo është e shënuar në libër, ajo për All-llahun është shumë lehtë"*¹³.**

E ka filluar All-llahu i Lartësuar këtë ajet duke e përmëndur diturinë e pastaj tha se ajo dituri është e shkruar në libër, domethënë e shkruar në Lehvi-Mahfudh, siç është transmetuar në një hadith nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: **"Gjënë e parë që e ka krijuar All-llahu është lapsi, dhe i ka thënë atij: "Shkruaj!", lapsi tha e çka të shkruajë? All-llahu i tha; "Shkruaj çdo gjë që ka ndodhur dhe çdo gjë që do të ndodhë deri në ditën e kjametit"**⁶

Për këtë është pyetur Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, për veprat që i bën njeriu, a caktohen në të ardhmën apo janë të caktuara në të kaluarën? Është përgjigjur: **"Janë të caktuara në të kaluarën"**⁷.

¹³ (El-Haxhxxh 70)

⁶ Tra.Ebu Davud (4700),Tirmidhiu (2155).

⁷ Tra. Ahmedi (1/29),Tirmidhiu (3111).

Po ashtu, është pyetur: "A ta braktisim punën dhe të mbështetemi në atë që na është shkruar në libër" ka thënë: **"Punoni sepse çdo kujt i lehtësohet për atë që i është shkruar"**⁸, pra Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i urdhëroi sahabet që të punojnë, atëherë ti o vëlla puno, sepse ty të lehtësohet për atë që të është shkruar, pastaj lexoi Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem disa ajete nga Kur'ani:

فَأَمَّا مَنْ أَعْطَىٰ وَاتَّقَىٰ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَىٰ فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْيُسْرَىٰ وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَىٰ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَىٰ فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْعُسْرَىٰ

"E, sa i përket atij që jep (nga pasuria e tij) dhe ruhet (nga mëkatet). Dhe beson bindshëm në All-llahun (apo në xhenetin), Ne atij do t'i lehtësojmë të bëjë mirë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe e ndien veten të pavarur (nga Zoti dhe shpërblimi i Tij). Dhe përgënjeshtroi All-llahun (apo xhenetin), Ne atij do t'i lehtësojmë të bëjë keqë"¹⁴.

Kategoria e tretë; Dëshira, do të thotë çdo gjë ekzistonë apo nuk ekziston në qiej dhe tokë ëshë me dëshirën e All-llahut të Lartësuar, kështu çdo gjë që ekziston është me dëshirën e All-llahut të Lartësuar, po ashtu çdo gjë që nuk ekziston është e All-llahut të lartësuar.

Ndërsa, kjo është përshkruar shumë mirë në Kur'an, ku All-llahu i Lartësuar e ka vërtetuar dëshirën e Tij në veprimin e Tij si dhe dëshirën e Tij në veprimet e robërve të Vet, thotë All-llahu subhanehu ue te'ala:

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

" (Kur'ani është përkujtues) Për këdo prej jush i cili dëshiron të ndjekë rrugën e vërtetë. Po ju nuk mundeni (ta ndiqni rrugën e vërtetë), vetëm nëse dëshiron All-llahu, Zoti i botëve!"¹⁵.

⁸ Tra. Buhariu (1362), Muslim (2647).

¹⁴ (El-Isj 5-10)

¹⁵ (Et-Tekvir 28-29)

وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ

"E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do bënëin atë (armiçësi)"¹⁶.

كَفَرَ ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَقْتَتَلُوا وَلَكِنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يُرِيدُ

"E sikur të dëshironte All-llahu ata nuk do të mbyteshin, por All-llahu punon çka dëshiron"¹⁷.

Ka treguar All-llahu i Lartësuar se veprimet e njerëzve janë me dëshirën e Tij, ashtu sikur që janë edhe veprimet e Tij subhanehu ve te'ala me dëshirën e Tij, thotë All-llahu i Lartësuar:

وَلَوْ شِئْنَا لَآتَيْنَا كُلَّ نَفْسٍ هُدًى

"Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilin njeri do ta udhëzonim"¹⁸.

Si dhe ajeti tjetër:

وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً

"Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje."¹⁹.

Në këto ajete si dhe shumë ajete të tjera është vërtetuar se veprimet e All-llahut kryhen me dëshirën e Tij subhanehu ue te'ala dhe nuk pranohet besimi në kader pos nëse beson se çdo gjë që ekziston apo që nuk ekziston është me dëshirën e All-llahut të Lartësuar.

Nuk ka diçka që nuk ekziston përveç se dëshira e All-llahut ka qenë të mos egzistojë, gjithashtu çdo gjë që ekziston është më dëshirën e All-llahut, nuk ka mundësi të këtë diçka në qiej e as në tokë pos më dëshirën e All-llahut të Lartësuar.

Kategoria e katërtë; Krijimi, do të thotë që të besojmë se All-llahu i Lartësuar është Krijues i çdo gjëje dhe se nuk ka krijesë në qiell e as në tokë përveq se All-llahu e ka krijuar, sa që edhe vdekjen e ka krijuar All-llahu i Lartësuar edhe pse vdekja është e kundërta e jetës, thotë All-llahu i Lartësuar:

¹⁶ (El -En'amë 112)

¹⁷ (El- Bekare 253)

¹⁸ (Es-Sexhde 13)

¹⁹ (El-Hudë 118)

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا

"Ai është i Cili krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë"²⁰

pra, çdo gjë që gjendet në qiej apo në tokë, All-llahu është krijues i saj dhe nuk ka krijues tjetër pos All-llahut të Lartësuar.

Ne e dimë se çdo gjë që ndodhë me veprimin e All-llahut sunbhanehu ue te'ala është krijesë e Tij, si p.sh.: qiejt, toka, kodrat, lumenjtë, dielli, hëna, yjet, erërat, njeriu dhe kafshët, të gjitha këto janë krijesa të All-llahut të Plotëfuqishëm, gjithashtu, cilësit e këtyre krijesave, ndryshimet dhe gjendjet e tyre, të gjitha këto janë të krijuara nga Allahu subhanehu ue te'ala.

Nganjëherë, ndodh që për njeriun të jetë e pakapshmne çështja dhe të thotë; Si ka mundësi të thuhet se veprat dhe fjalët tona të cilat i kryejmë me vullnetin tonë, të jenë të krijuara nga Allahu az-ze ue xhel?! themi; Po, bën të pranohet kjo, sepse veprat dhe fjalët tona janë rezultat i dy çështjeve:

- **fuqisë;**
- dhe **dëshirës apo vullnetit.**

Nëse veprimi i njeriut është rezultat i fuqisë dhe dëshirës se tij, atëherë, ai i cili e ka krijuar këtë dëshirë dhe e ka bërë zemrën e njeriut pranuese të saj është All-llahu az-ze ue xhel, poashtu, ai i cili e ka krijuar fuqinë e tij është All-llahu i Plotëfuqishëm dhe Ai është që e ka krijuar shkakun nga i cili rrjedh rezultati, apo mund të themi; krijuesi i shkakut është krijuesi i rezultatit-veprës që do të thotë Ai i cili e ka krijuar gjurmëlënësin Ai njëherit është edhe krijues i gjurmëve, pra çështja se All-llahu subhenehu ue te'ala ka krijuar veprën e njeriut qëndron ashtu siç thamë edhe më parë; veprat dhe fjalët tona janë rrezultat i dy çështjeve:

- **fuqisë;**
- dhe **dëshirës apo vullnetit.**

Sikur mos të ishte dëshira njeri nuk do të mund të vepronte asgjë, poashtu sikur të mos ishte fuqija nuk do të bënte gjë, sepse nëse dëshiron të bëjë diçka e nuk ka fuqi nuk mund të vepron, po nëse ka fuqi por nuk ka dëshirë të veprojë nuk ka veprim.

²⁰ (El-Mulk 2)

Pra, nëse veprimi është si rrjedhojë apo si rezultat i vullnetit të plotë dhe fuqisë së madhe, atëherë Ai i Cili i ka krijuar këto dyja është All-llahu.

Nga kjo na është bërë e qartë se si mund të themi se; All-llahu i Lartësuar është Krijues i veprimit të njeriut, ndërsa në realitet njeriu është veprues, p.sh.; vetvetiu pastrohet, falet, jep zekatin, agjëron, shkon në haxh, bën umre, është mëkatarë, dhe është i përlur, mirëpo këto veprime janë kryer si rezultat i ekzistimit të dëshirës dhe fuqisë të cilat All-llahu az-ze ue xhel i ka krijuar, uelhamdulil-lah puna është e qartë.

Kategoritë të cilat i përmendëm më lartë është obligim të besojmë se janë vepra të All-llahut të Plotëfuqishëm, por kjo nuk përjashton që vepruesit me vullnet të lirë t'i atribohet vepra e tij.

Siç është e ditur zjarri djegë, kurse ai i cili e ka krijuar djegjen është All-llahu dhe në këtë nuk ka farë dyshimi, dhe nuk ka mundësi zjarri të shkaktojë djegje vetvetiu, mirëpo zjarri djeg ngase All-llahu i Lartësuar e ka bërë të tillë, mu për këtë arsye zjarrin në të cilin e kanë hedhur Ibrahimin alejhis-selam pabesimtarët nuk ishte djegës, ngase Allahu i Lartësuar i tha atijë (zjarrit):

قُلْنَا يَنَّا رُ كُونِي بَرْدًا وَسَلَامًا عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ

***"Bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin"*²¹**

do të thotë zjarri u bë i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin, ngase zjarri vetvetiu nuk djeg mirëpo është All-llahu Ai i Cili e bënë atë të djegë Pra, fuqia e djegjes përballë veprës së njeriut është sikur vullneti dhe fuqia e njeriut, me bashkimin e dëshirës dhe fuqisë shkaktohet veprimi sikurse që me lëndë djegse në zjarrë shkaktohet djegja, nuk ka dallim mes tyre por njeriu pasi që posedon dëshirë, ndjenja, vullnet të lirë dhe veprim atëherë puna e tij i atribohet atij në realitet dhe vendim dhe jep llogari nëse kundërshton duke u dënuar për kundërshtimin e tij, sepse ai vepron apo nuk vepron me vetëdëshirë.

²¹ (Enbija 69)

Në fund është obligim për besimtarin që të jetë i kënaqur me All-llahun si Zot të tij, njëherit prej plotësimit të besimit në rububijetin e Tij është të besojë në kaderin e All-llahut dhe ta dijë se nuk ka dallim në mes veprave të cilat i bënë dhe në mes rrizkut pas të cilit vrapon, apo në mes veprave që i bënë dhe në mes fatkeqësive të cilat mundohet t'i evitojë, e tërë kjo është e njëjtë, e gjithë kjo është e shkruar, e tërë kjo është e caktuar, mirëpo çdo njeriut i është lehtësuar për atë që i është caktuar.

Kërkoj prej All-llahut subhanehu ue te'ala që të na bëjë prej atyre të cilve iu është lehtësuar të veprojnë ashtu si veprojnë njërzit e lumtur (besimtarët) dhe të caktojë për neve të mirat në këtë botë dhe në të ahiret.

Falendërimi i qoftë All-llahut, Zotit të botërave, ndërsa mëshira e All-llahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, familjen dhe mbi gjithë shokët e tij.

